

VENDIM
Nr.281, datë 18.3.2009

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT “SHKOLLA E LARTË
NDËRKOMBËTARE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës” do të organizohet në dy fakultete:

a) Në Fakultetin e Drejtësisë, me programin e studimit me kohë të plotë në “Drejtësi”;

b) Në Fakultetin e Ekonomisë, me programet e studimit me kohë të plotë në:

i) “Ekonomi-Financë”,

ii) “Ekonomi-Menaxhim”.

3. “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës” do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 (tri) vite, dhe në mbarim të tyre do të lëshojë “Diplomë të nivelit të parë (DNP)”, përkatësisht në:

a) Drejtësi,

b) Ekonomi-Financë,

c) Ekonomi-Menaxhim.

4. Ngarkohet “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës”, që, për çdo program studimi, të sigurojë nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplineve kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialiteteve.

5. “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. “Shkolla e Lartë Ndërkombëtare e Tiranës” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë së institucionit dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha